



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 29 Nëntor 2016
Nr.ref.:RK1008/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI99/16

Parashtrues

MuhamedAli Ceyşülmedine

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në
Prizren, Ac. nr. 35/2003, të 23 qershorit 2004**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga MuhamedAli Ceyşülmedine nga Prizreni (në tekstin e mëtejme parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin Ac. nr. 35/2003 të Gjykatës së Qarkut në Prizren, të 23 qershorit 2004.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 119 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura na Gjykatën Kushtetuese

5. Më 29 qershor 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 17 korrik 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Ivan Čukalović (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Gresa Caka-Nimani.
7. Më 22 korrik 2016, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që ta plotësojë formularin dhe ta sqarojë kërkesën.
8. Më 2 gusht 2016, Gjykata njoftoi Gjykatën Themelore në Prizren për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën kohë, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore në Prizren që ta njoftojë Gjykatën se në cilën fazë janë procedurat lidhur me këtë çështje.
9. Më 4 gusht 2016, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë formularin e plotësuar të kërkesës.
10. Më 11 gusht 2016, Gjykata Themelore në Prizren (shkresa Ndr. nr. 364/04) e njoftoi Gjykatën se procedurat janë në pritje dhe se shqyrtimi i ardhshëm është caktuar për 23 shtator 2016, në orën 13:30.
11. Më 17 tetor 2016, Kolegji shqyrtues, pasi e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve të përgjithshme

12. Më 7 prill 1949, Organi Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Qytetit të Prizrenit (Aktvendimi nr. 6867) urdhëroi rrënimin e ndërtesës në sipërfaqe të përgjithshme prej 67 m² në pronësi të Qazim Hoxhës (të atit të parashtruesit të kërkesës) për shkak të *“vjetërsimit dhe prirjes për shembje”* të ndërtesës.
13. Trashëgimtarët e Qazim Hoxhës i kanë zhvilluar procedurat pranë gjykatave të Republikës Federative të Jugosllavisë, por procedurat çdoherë janë kthyer në gjykatën e shkallës së parë në rivendosje.
14. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës dhe trashëgimtarët e tjerë të Qazim Hoxhës kërkuar nga Gjykata Komunale në Prizren *“që gjykata të bjen aktvendim me të cilin aktvendim ish pronarëve do t’u bëhet kompensimi për paluajtshmërinë e eksproprijuar në të holla të gatshme, dhe atë në shumën që do ta cakton gjykata me angazhimin e ekspertit gjegjës”*.
15. Më 11 qershor 2002, Gjykata Komunale në Prizren (Aktvendimi Ndr. nr. 6/98) caktoi *“kompensimin për paluajtshmërinë e eksproprijuar [...] në shumë të përgjithshme prej 469.000 (katërqindëgjashtëdhjetëenëntëmijë) euro”* dhe e detyroi *“shfrytëzuesin e eksproprijimit - Komuna e Prizrenit, që ish pronarit Qazim Hoxha, [...] respektivisht trashëgimtarëve të tij ligjor [...], t’ia kompensoj shumën e të hollave për paluajtshmërinë e eksproprijuar”* në shumën e përmendur.
16. Avokati publik komunal parashtroi ankesë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.
17. Më 23 qershor 2004, Gjykata e Qarkut në Prizren (Aktvendimi Ac. nr. 35/2003) e aprovoi si të bazuar *“ankesën e avokatit publik komunal, prishi aktvendimin e Gjykatës Komunale dhe e ktheu lëndën në rivendosje”*.
18. Më 19 nëntor 2004, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut.
19. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës dërgoi një numër të madh të shkresave, lutjeve dhe kërkesave tek institucionet e ndryshme, përkatësisht: Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Parlamentit Evropian dhe Misionit të EULEX-it në Kosovë.
20. Më 3 prill 2015, Misioni i EULEX-it në Kosovë iu përgjigj tri shkresave të parashtruesit, duke arsyetuar se EULEX-i *“nuk ka mandat për të marrë përsipër lëndë civile”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *“gjithkund në autoritetet publike në Kosovë (...), ka keqpërdorime të pozitës zyrtare, madje edhe në prokurori”*.

22. Më tej, parashtruesi i kërkesës nuk arsyeton se si janë shkelur nenet e caktuara të Kushtetutës. Ai vetëm thekson si në vijim:

*“Në Kosovë nuk ekziston barazia para ligjit.
Në Kosovë (në praktikë) nuk ekziston e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.
Ligji është më shumë shkronjë e vdekur në letër në raport me praktikën.
Në rastin tim nuk ekziston mbrojtja e pronës. Shih nenin 46 të Kushtetutës së R. së Kosovës.
Në rastin tim nuk ekziston mbrojtja gjyqësore e të drejtave. Shih nenin 54 të Kushtetutës së R. së Kosovës.
Sipas nenit 119 të Kushtetutës së Kosovës duhet të ketë siguri të pronës publike dhe private. Në rastin tim nuk ekziston siguria e pronës private”.*

23. Parashtruesi i kërkesës i propozon Gjykatës:

“... të aprovojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë në Prizren Ndr. nr. 6/98, të datës 11.06.2002, me kamatë-vonesën prej ditës së pranimit të aktgjykimit, ndërsa i padituri është i obliguar të paguajë kompensimin për lokalet afariste të ekspropriuara, si dhe të anulohet aktvendimi i padrejtë i gjykatës së shkallës së dytë të atëhershme sepse është i bazuar në aktvendimet e anuluar paraprakisht...”.

Pranueshmëria e kërkesës

24. Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
25. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

26. Gjykata gjithashtu i referohet edhe paragrafit 2, të nenit 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit, i cili përcakton:

Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

27. Për më tepër, Gjykata merr parasysh rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar.

28. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se më 11 gusht 2016, Gjykata Themelore në Prizren njoftoi se procedurat janë në pritje dhe se shqyrtimi është caktuar për 23 shtator 2016, në orën 13:30. Prandaj, mjetet juridike në dispozicion nuk janë shteruar.
29. Gjykata thekson se rregulli i shterimit të mjeteve juridike në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës i obligon ata individë që dëshirojnë ta parashtrojnë rastin e tyre në Gjykatë që së pari të shfrytëzojnë të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit.
30. Gjykatave të rregullta duhet t'u ofrohet mundësia të korrigjojnë gabimet e tyre eventuale nëpërmjet procedurës së rregullt gjyqësore, para se lënda të vijë në Gjykatë. Ky rregull bazohet në supozimin e shprehur në nenin 32 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së, që sipas legjislacionit vendor ekzistojnë mjete juridike pranë gjykatave të rregullta të cilat janë në dispozicion në lidhje me gabimet e pretenduara, pavarësisht nëse dispozitat e KEDNJ-së janë inkorporuar në të drejtën nacionale ose jo (Shih, *inter alia* Aksoy kundër Turqisë paragrafi 51, Aktgjykim i GJEDNJ-së, i 18 dhjetorit 1996).
31. Parimi është që mekanizmi i mbrojtjes i themeluar me gjyqësinë kushtetuese të jetë subsidiar në raport me sistemin e rregullt të gjyqësorit që mbron të drejtat e njeriut (Shih, *inter alia*, Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, paragrafi 48 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 7 dhjetorit 1976).
32. Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të ndjekë në mënyrë të rregullt mjetet juridike që janë në dispozicion dhe të mjaftueshme për të siguruar mundësinë e korrigjimit të shkeljeve të pretenduara. Ekzistimi i mjeteve juridike në fjalë duhet të jetë mjaftueshëm i sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, dhe nëse kjo nuk është kështu, atyre mjeteve juridike do t'u mungojë qasshmëria dhe efektshmëria e duhur (Shih, *inter alia*, Vernillo kundër Francës, paragrafi 27 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 20 shkurtit 1991, dhe Dalia kundër Francës, paragrafi 38 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 19 shkurtit 1998).
33. Gjykatës i takon që ta shqyrtojë nëse janë shteruar mjetet juridike, efektive dhe në dispozicion, në teori dhe praktikë në kohën relevante, përkatësisht nëse mjeti juridik ka qenë i disponueshëm, që ka mundur të korrigjojë shkeljet në raport me kundërshtimet e parashtruesit të kërkesës dhe se ka mundësuar perspektivë të arsyeshme për sukses (Shih, *inter alia*, Civet kundër Francës, paragrafët 42-44 të Aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 28 shtatorit 1999).
34. Gjykata vëren se Aktvendimi i kontestuar e kthehen lënden në Gjykatën Komunale në Prizren për rivendosje, ku ende është në pritje.

35. Përveç kësaj, sipas informatave të parashtruesit të kërkesës më 19 nëntor 2004, ai kishte parashtruar kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut.
36. Gjykata vëren se procedurat në gjykatat e rregullta ende nuk kanë përfunduar, dhe për këtë arsye kërkesa është e parakohshme.
37. Në këtë rast, Gjykata rithekson se gjykatat e rregullta janë të pavarura në ushtrimin e pushtetit të tyre gjyqësor dhe detyra e tyre kushtetuese është t'i interpretojnë çështjet faktike dhe të ligjit, të cilat janë të rëndësishme për rastet e ngritura para tyre.
38. Arsyetimi për rregullin që procedurat në gjykatat e rregullta duhet të përfundohen në mënyrë që gjykatave të rregullta t'u ofrohet mundësia për të korrigjuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës siguron mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese (Shih, Aktvendimin për papranueshmëri, *Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K., Prishtinë, kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*, KI41/09, të 21 janarit 2010, dhe shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803/94, Aktvendimi i 28 korrikut 1999).
39. Nga sa u tha më lart, Gjykata nuk do të lëshohet në shqyrtimin e shkeljeve të tjera të pretenduara të Kushtetutës, në të cilat thirret parashtruesi i kërkesës, pasi që ai nuk i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me ligj dhe Rregullore të punës.
40. Prandaj, Gjykata konstaton se procedurat në gjykatat e rregullta janë ende në pritje dhe rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit është e papranueshme, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) (b) dhe 56të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 17 tetor 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Vjosa Rama-Hajrizi